



---

**Hapet thirrja për mobilitete (bursa) studentësh të Universitetit  
Politeknik të Tiranës  
në kuadër të Marrëveshjes KA1 të Programit Erasmus + në  
Universidad de Sevilla, Spanjë**

Në kuadër të programit Erasmus+ dhe marrëveshjes KA1 bilaterale, është hapur thirrja për aplikime për bursa për mobilitete për studentët e Universitetit Politeknik të Tiranës, në Universidad de Sevilla.

**Llojet e mobilitetit përfshijnë:**

Shkëmbimin e studentëve për studime.

**Nivelet e mobilitetit për studentët:**

Studentët duhet të jenë të regjistruar në Universitetin Politeknik të Tiranës, Fakulteti i Arkitekturës dhe Urbanistikës, Fakulteti i Inxhnierisë Mekanike, Fakulteti i Inxhnierisë Elektrike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.

Kohëzgjatja e bursave: Semestri i I, 2025 - 2026

**Numri total i studentëve: 1**

**Dokumentat e nevojshme për aplikim për studentët:**

- CV;
- Kopje e Pasaportës;
- Vërtetim studenti;
- Listë notash e studimeve, deri në momentin e aplikimit;
- Letër Motivimi (në gjuhën angleze, ose spanjolle);
- Çertifikatë e gjuhës së huaj\*;



**Key Action 1**  
**- Mobility for learners and staff -**

---

\*Ofrohen kurset e studimit në gjuhën angleze, ku niveli minimal i kërkuar për gjuhën, për studenët është të paktën B1. Studentët janë gjithashtu të mirëpritur të zgjedhin kurse spanjisht, ku niveli minimal i gjuhës spanjolle është B1. Studentët duhet të plotësojnë nivelin minimal të kërkuar të gjuhës duke e vërtetuar me çertifikatën përkatëse të gjuhës së huaj.

\*\*Learning Agreement është një kontratë midis universitetit të origjinës dhe aplikantit dhe shërben për të përcaktuar lëndët që do të zhvillohen në universitetin pritës. Ju duhet të plotësoni vetëm seksionin e parë “Mobility Plan”. Në tabelën A përcaktohen lëndët dhe kreditet që do të merrni në universitetin pritës, në tabelën B përcaktohet se cilat prej lëndëve të Tabelës A do të njihet në Universitetin Politeknik të Tiranës, kur ju të keni përfunduar periudhën e shkëmbimit.

KUJDES: Ju duhet të përzgjidhni të kryeni në Universidad de Sevilla, Spanjë, lëndë të njëjta ose ekuivalente me ato që do të kryenit në semestrin përkatës në fakultetin tuaj, kjo për arsye që lëndët dhe kreditet t’ju njihen kur të ktheheni. Nëse lëndët e përzgjedhura ndryshojnë nga ato që do të zhvillohen në fakultetin tuaj semestrin përkatës, atëherë kur të ktheheni ju duhet të zhvilloni lëndët që nuk përshtaten në Universitetin Politeknik të Tiranës.

Dokumenti “Learning Agreement” të seksioni “Commitment” firmoset nga aplikanti, nga koordinatori akademik i fakultetit dhe nga Zv/Rektori i UPT-së për Anën Shkencore.

Klikoni në këtë link për t’u njohur me lëndët që ofron Universidad de Sevilla: [University of Seville](https://www.us.es/)

**Afati për aplikim: Deri më 25 prill 2025, ora 12.00**

Aplikimi kryhet në Drejtorinë e Komunikimit dhe Koordinimit.

Për informacione shtesë, në lidhje me procesin e aplikimit, mund të kontaktoni në email: , [rkodra@upt.al](mailto:rkodra@upt.al) , [abeqo@upt.al](mailto:abeqo@upt.al)